



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.4.2023

Nr: 300

Ora: 12:00

VENDIM

**MBI PROCESIN E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE TË KANDIDIMIT PËR KRYETARËT E DISA BASHKIVE, PËR SUBJEKTIN ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot, më datë 5.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen me:

**OBJEKT:** Verifikimi i deklarimeve në formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, neni 33, shkronja "f" i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja "a", i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

VËREJ:

Subjektet zgjedhore, në përputhje me nenin 5, pika 4, shkronja "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", kanë depozituar formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksione publike.

Subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", me shkronja nistore "PS", ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentacionet përkatëse për të gjithë kandidatët, bazuar në udhëzimin nr. 1. datë 18.01. 2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Data: 5.4.2023 Nr: 300  
Ora: 12:00



"Mbi procesin e verifikimit të kushteve të kandidimit për kryetarët e disa bashkive, për subjektin zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Nga verifikimi *prima facie* i formularëve të kandidatëve për kryetarë bashkie rezulton se asnjë e dhënë nuk është në kundërshtim me ndalimet e parashikuara nga ligji. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat për kryetar bashkie. Nga verifikimi paraprak i formularëve të vetëdeklarimit të kandidatëve për kryetar bashkie rezulton se, nuk janë në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji 138/2015 dhe janë të padënuar me vendim penal të formës së prerë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pikat 2, shkronja "b" e 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nëpërmjet postës elektronike, për kandidatët për kryetar bashkie që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatët për kryetar bashkie sipas së cilës rezulton se kandidatët nuk janë në kushtet e ndalimit dhe nuk janë të dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, edhe pse nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është nisur lista për verifikim, ende nuk i ka kthyer përgjigje kërkesës sonë.

Referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i ndryshuar dhe Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nga kandidatët për kryetar bashkie, të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin e tyre, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Referuar nenit 33, shkronja "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Për sa më sipër, KZAZ-të duhet të vazhdojnë procedurat për regjistrimin e kandidatëve për kryetar bashkie, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

## PËR KËTO ARSYE:

Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, neni 33, shkronja "f" i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe neni 5, pika 4 shkronja "a", i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Data: 5.4.2023 Nr: 300  
Ora: 12:00



"Mbi procesin e verifikimit të kushteve të kandidimit për kryetarët e disa bashkive, për subjektin zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

## V E N D O S:

1. Miratimin e rezultateve të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit për kandidatët për kryetar bashkie, të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për disa bashki dhe lejimin e kandidimit të tyre.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

**Partia Socialiste e Shqipërisë**

NR	BASHKIA	KANDIDATI
1	Bashkia Dimal	Juliana Mema
2	Bashkia Kucovë	Kreshnik Hajdari
3	Bashkia Polican	Adriatik Zotkaj
4	Bashkia Skrapar	Adriatik Mema
5	Bashkia Bulqizë	Festime Mjeshtri
6	Bashkia Dibër	Rahim Spahiu
7	Bashkia Klos	Valbona Kola
8	Bashkia Mat	Agron Malaj
9	Bashkia Krujë	Artur Bushi
10	Bashkia Shijak	Elton Arbana
11	Bashkia Belsh	Arif Tafani
12	Bashkia Cërrik	Andis Salla
13	Bashkia Gramsh	Besjon Ajazi
14	Bashkia Librazhd	Mariglen Disha
15	Bashkia Peqin	Bukurosh Maçi
16	Bashkia Divjakë	Josif Gorrea
17	Bashkia Mallakastër	Qerim Ismailaj
18	Bashkia Patos	Fation Duro
19	Bashkia Roskovec	Majlinda Bufi
20	Bashkia Dropull	Dhimitraq Toli
21	Bashkia Këlcyrë	Klement Ndoni
22	Bashkia Libohovë	Leonard Hide
23	Bashkia Memaliaj	Gjolek Guci
24	Bashkia Përmet	Alma Hoxha
25	Bashkia Tepelenë	Tërmet Peçi
26	Bashkia Devoll	Eduard Duro
27	Bashkia Kolonjë	Erion Isai
28	Bashkia Maliq	Gëzim Topçiu
29	Bashkia Pogradec	Illir Xhakolli
30	Bashkia Pustec	Pali Kolefski
31	Bashkia Has	Beqir Mulaj
32	Bashkia Kukës	Safet Gjici
33	Bashkia Tropojë	Rexhe Byberi
34	Bashkia Kurbin	Majlinda Cara
35	Bashkia Fushë-Arrëz	Fran Tuci
36	Bashkia Malësi e Madhe	Tonin Marinaj
37	Bashkia Pukë	Gjon Gjonaj
38	Bashkia Vau i Dejës	Kristian Shkreli
39	Bashkia Kavajë	Redjan Krali
40	Bashkia Rrogozhinë	Edison Memolla



41	Bashkia Vorë	Blerim Shera
42	Bashkia Delvinë	Besmir Veli
43	Bashkia Himarë	Jorgo Goro
44	Bashkia Konispol	Ergest Dule
45	Bashkia Sarandë	Oltjon Çaçi
46	Bashkia Selenicë	Nertil Bellaj
47	Bashkia Mirditë	Ndrec Dedaj
48	Bashkia Prrenjas	Nuri Belba
49	Bashkia Gjirokastrë	Flamur Golemi

